



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:021199

Datë: 20.11.2024

Numri i dokumentit: 06479238

**C-IV.-13-3243**

*Paditësi:*

**D P**, Zh, Serbi.

*Të cilin e përfaqëson Zyra për Ndihmë Juridike Falas, Graçanicë.*

**Kundër**

*E paditura:*

**N.SH “Fabrika e Amortizatorëve”**, të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Dritan Hoxha”, Lakrishte, nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Dr.sc.Murat Hulaj, me dt.19 nëntor 2024, lëshon këtë:

## A K T G J Y K I M

- REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e ankuesit, dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.PRN047-0270 i dt.23 tetor 2013 si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- Secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.22 nëntor 2013, ankuesi parashtrori ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr.PRN047-0270 i dt.23 tetor 2013, për kompensimin e tri pagave të pa paguara gjatë vitit 1999, në shumë prej 2,218.00€ kundër N.SH “Fabrika e Amortizatorëve”. E paditura ia ka refuzuar ankesën pasi që ankuesi nuk ka dorëzuar kërkesë në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent, por e paditura ka qenë organi kompetent për të paraqitur ankesën. Ankesës nuk i ka bashkangjitur prova.

E paditura e ka paraqitur mbrojtjen e saj me dt.11 tetor 2018, ku ka pohuar se vendimi i AL nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore në fuqi janë zbatuar drejtë. Konsideron se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të kundërshtuar. Parashtruesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur AL me vendimin e saj dhe nuk ka ofruar asnjë argument ligjor. Ka shtuar se ankesa e ankuesit është parashkruar konform nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar pasi që i njëjti nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë para ndonjë organi kompetent apo gjykate. Ka kërkuar që në bazë të dispozitave ligjore, gjykata ta refuzoj ankesën e ankuesit. I ka bashkangjitur vendimin e kundërshtuar nga ankuesi.

Me dt.04 prill 2024, gjykata i është drejtuar me urdhër Zyrës për Ndihmë Juridike falas e cila e përfaqëson ankuesin, përmes të cilit ka kërkuar që të bëjë dorëzimin e provave në mbështetje të pretendimeve ankimore duke ia specifikuar secilën veç e veç. Të njëjti i janë përgjigjur gjykatës me dt.24 prill 2024, duke theksuar se të gjitha provat që i posedon ankuesi gjenden në shkresat e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për tri paga të pa paguara. Ankuesi ka dorëzuar vetëm kopjen

e vendimit të kundërshtuar. Ankuesi ka dështuar që të dorëzoj prova relevante në mbështetje të ankesës së tij edhe pas parashtrimit të urdhrimit të dt.04 prill 2024.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte se sa ka ofruar shërbime pranë ndërmarrjes, kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës si dhe cila ka qenë paga të cilën ankuesi e ka pranuar nga e njëjta, si dhe listën e pagave të cilat pretendon se ankuesit i kanë mbetur borxh. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për tri paga të pa paguara gjatë vitit 1999, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Ankuesi nuk a ka bërë as dorëzimin e kopjes së vendimit të kundërshtuar, por meqenëse i njëjti është siguruar nga e paditura, gjykata është lëshuar në merita të lëndës dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket parashkrimit të kërkesës të cilën e paditura është thirrur, gjykata e vlerësoi pa e marr si pretendim kryesor, për faktin se çështja e parashkrimit është institut i veçantë me afate të përcaktuara me ligj. Por, në këtë rast gjykata u mbështet në provat e prezantuara nga ankuesi, të cilat ishin të mjaftueshme për t'ia refuzuar kërkesën përtej afateve ligjore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore meqenëse përfaqësohet nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas.

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**G j y q t a r i,**

Dr.sc.Murat Hulaj,

---